



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 192, datë 26.10.2021

**MBI
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË DHE ZGJERIMIT TË LICENCËS SË
SHOQËRISË “BANKA KOMBËTARE TREGTARE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21 dhe nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOJ SE:

Shoqëria “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., disponon licencën nr. 4, datë 25.06.2009 “Për ushtrim veprimtarie tregëtimi në letrat me vlerë” me cilësinë “si shoqëri brokerimi (broker-dealer) në letrat me vlerë të Qeverisë së RSH-së në bursë dhe në tregun me pakicë”, si dhe licencën nr. 7, datë 18.11.2010 “Për të vepruar si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH”, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, i shfuqizuar. Licencat e shoqërisë janë të kufizuara vetëm në shërbimet me titujt e Qeverisë.

Licenca si shoqëri brokerimi (broker-dealer) nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara, sipas Ligjit nr. 62/2020, është e njëjtë me shërbimet e investimit: Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit, ekzekutim urdhërash dhe tregtim për llogari të vet, ndërsa shërbimi i kujdestarisë apo ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve, konsiderohet shërbim ndihmës.

Shoqëria “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., ka paraqitur raportin e përshtatshmërisë së veprimtarisë me kërkesat e Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të

tij, në përputhje me nenin 24, pika 2, të Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, si dhe ka depozituar kërkesën për zgjerimin e licencës me qëllim ofrimin e shërbimit të marrjes dhe transmetimit të urdhërave, ekzekutimin e tyre në emër të klientit, tregtimin për llogari të vet në disa instrumente financiare, si dhe ofrimin e shërbimit ndihmës të kujdestarisë në instrumente financiare, (jo vetëm në titujt e Qeverisë). Gjithashtu, kërkesa shtrihet edhe në ofrimin e shërbimeve ndihmëse, që lidhen me shërbimet e investimit, si:

- Shërbimet e këmbimit valutor kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj;
- Shërbimet dhe veprimtaritë e investimit në tituj, si edhe shërbimet ndihmëse të lidhura me instrumentet derivative kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj ose shërbimeve të tjera ndihmëse.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij, për:**

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit në titujt e Qeverisë si:

- a) Marrje dhe transmetim i urdhërave;**
- b) Ekzekutim i urdhërave në emër të klientëve;**
- c) Tregtim për llogari të vet.**

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në titujt e Qeverisë si:

“Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve”.

- 2. Miratimin e zgjerimit të licencës së shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare” në instrumentet financiare dhe shërbimet ndihmëse, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE

Zgjerimi i licencës së shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., miratohet për:

I. Ofrimin e shërbimeve të investimit dhe shërbimit ndihmës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, për të gjitha instrumentet financiare si më poshtë:

Instrumentet financiare

1. Titujt e transferueshëm;
2. Instrumentet e tregut të parasë;
3. Kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative lidhur me tituj, monedha, norma interesi ose kthimi (yields), kuotat e lejuara për çlirim të gazeve serrë ose instrumente të tjera derivative, indekse financiare ose njësi financiare, të cilat mund të shlyhen fizikisht ose me para;
4. Kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat e shitjes në të ardhmen me çmim të paracaktuar (forwards) dhe çdo kontratë tjetër derivative në lidhje me mallra (commodities) që duhet të shlyhen në para ose që mund të shlyhen në para me zgjedhjen e njëres prej palëve, duke përjashtuar rastet e zgjidhjes së kontratës për mospërbushje ose për ndonjë arsye tjetër;
5. Kontratat e opsioneve (options), kontratat e së ardhmes (futures), marrëveshjet e shkëmbimit (swap) dhe kontrata të tjera derivative në lidhje me mallra (commodities), që mund të shlyhen fizikisht me kusht që të tregtohen në një treg të rregulluar, në një platformë shumëpalëshe tregtimi, ose në një platformë të organizuar tregtimi, me përjashtim të produkteve energjetike të tregtuara me shumicë në një platformë të organizuar tregtimi, të cilat duhet të shlyhen fizikisht;
6. Kontratat financiare për diferencat.

II. Ofrimin e shërbimeve ndihmëse për të gjitha instrumentet financiare të listuara më sipër, si:

- Shërbimet e këmbimit valutor kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj;
- Shërbimet dhe veprimtaritë e investimit në tituj, si edhe shërbimet ndihmëse të lidhura me instrumentet derivative kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj ose shërbimeve të tjera ndihmëse.